



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit – Ured Premijera – Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 5: Statistikat Sociale

VLERËSIM

Popullsia e Kosovës 2024



Prishtinë, 2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 5: Statistikat Sociale

VLERËSIM

Popullsia e Kosovës 2024



Botues: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)
Data e botimit: Qershor, 2025
© Agjencia e Statistikave të Kosovës
Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.
Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes ueb-faqes së ASK-së:
<http://ask.rks-gov.net>

Parathënie

Raporti për Vlerësimin e Popullsisë së Kosovës është një publikim statistikor vjetor që synon të ofrojë vlerësime sa më të sakta dhe të besueshme mbi numrin e popullsisë së vendit në periudhën ndërmjet dy regjistrimeve të përgjithshme të popullsisë.

Në periudhën ndërmjet dy regjistrimeve, që zakonisht shtrihet në një interval dhjetëvjeçar, popullsia e një vendi pëson ndryshime të vazhdueshme dhe dinamike, të cilat reflektojnë lindjet, vdekjet, migrimet, si dhe ndryshimet e tjera demografike. Këto vlerësime janë thelbësore për kryerjen e analizave të detajuara socio-ekonomike dhe janë burim kryesor për hartimin e politikave të zhvillimit ekonomik e social, planifikimin urban dhe rajonal, alokimin buxhetor, përcaktimin e indikatorëve të punësimit dhe standardit jetësor, si dhe për llogaritjen e treguesve të llogarive kombëtare.

Të dhënat mbi popullsinë janë kritike jo vetëm për vendimmarrësit dhe hartuesit e politikave, por edhe për analistët, studiuesit, akademikët dhe të gjithë përdoruesit e tjerë të të dhënave statistike, duke u ofruar atyre bazë të fortë për vendime dhe analiza të bazuara në evidencë.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) mbetet e përkushtuar që çdo vit të ofrojë vlerësime të përditësuara, duke ndjekur praktikën më të mira ndërkombëtare në metodologji, cilësi dhe transparencë. Këto vlerësime realizohen në nivel vendi dhe komune, duke mundësuar kështu një pasqyrë të plotë dhe të detajuar të situatës demografike në Kosovë.

Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet tuaja mund të dërgoni në adresën e ueb faqes (infoask@rks-gov.net).

Naime Rexhepi	-	Drejtoreshë e Departamentit të Statistikave Sociale
Valdete Navakazi	-	Udhëheqëse e Divizionit të Statistikave të Popullsisë

Publikimin e përgatitën:

Arbert Abdyl	-	Zyrtar i Statistikave të Migrimit
Arijeta Sojeva	-	Zyrtare e Lartë e Statistikave Vitale
Vjollca Berisha	-	Zyrtare e Lartë e Statistikave Vitale

Qershor, 2025

Drejtor Ekzekutiv i ASK-së
Avni Kastrati

Lista e shkurtesave dhe simboleve

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
MPB	-	Ministria e Punëve të Brendshme
MASHTI	-	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
IOM	-	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
UNHCR	-	Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
EUROSTAT	-	Zyra Statistikore e Bashkimit Evropian
EFTA	-	Asociacioni i Tregtisë së Lirë të Evropës
0	-	E dhëna është më e vogël se 0,5 e njësisë së dhënë të matjes
:	-	Mungojnë të dhënat
-	-	Nuk ka dukuri

Përmbajtja

Faqe

HYRJE	8
Për shfrytëzuesit e të dhënave.....	8
Baza për vlerësimin e popullsisë.....	8
Vështrim metodologjik.....	8
Burimet e të dhënave.....	8
Popullsia bazë dhe komponentët demografikë	8
Popullsia bazë.....	8
Migrimi ndërkombëtar	9
Rritja e përgjithshme e popullsisë	9
Tabela: 1: Popullsia e Kosovës dhe shtimi natyror për vitin 2024 në nivel të komunave	10
Tabela: 2. Popullsia e Kosovës dhe migrimi për vitin 2024 në nivel të komunave	11
Tabela: 3. Popullsia e vlerësuar e Kosovës për vitin 2024 në nivel të komunave	12

HYRJE

Për shfrytëzuesit e të dhënave

Raporti përfshin ndryshimet e numrit të popullsisë (shtimin natyror dhe migrimin) gjatë periudhës 1 janar- 31 dhjetor 2024 në territorin e Kosovës.

Baza për vlerësimin e popullsisë

Vështrim metodologjik

Vlerësimi i numrit të popullsisë rezidente në nivel kombëtar/komunal ndikohet nga nataliteti, mortaliteti dhe migrimi (NMM).

Vlerësimi i popullsisë: popullsia bazë + nataliteti – mortaliteti ± migrimi i jashtëm/brendshëm.

Të dhënat e vlerësuara përfundimtare për numrin e popullsisë në nivel të komunave janë

llogaritur sipas procedurave të mëposhtme:

$$P_t = P_{t-1} + (L_t - V_t) + (I_t - E_t)$$

Ku

P_t – popullsia rezidente më 31 dhjetor të vitit t (2024);

P_{t-1} – popullsia rezidente më 31 dhjetor të vitit t-1 (2023);

L_t – lindjet rezidente gjatë vitit t (2024);

V_t – vdekjet rezidente gjatë vitit t (2024);

I_t – hyrjet (imigrimi) gjatë vitit t (2024);

E_t – daljet (emigrimi) gjatë vitit t (2024).

Burimet e të dhënave

Burimet e përdorura në hartimin e këtij raporti përfshijnë: vlerësimin paraprak të popullsisë së vitit 2023, bazën e të dhënave nga Regjistrimi i Popullsisë 2024, të dhënat e Statistikave të indjeve dhe vdekjeve (ASK), të dhënat administrative nga institucionet relevante vendore si komunat dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), si dhe burime statistikore ndërkombëtare nga institucionet statistikore të vendeve të destinacionit kryesor të migracionit kosovar. Të gjitha këto të dhëna janë verifikuar, përpunuar dhe analizuar duke zbatuar metoda statistikore rigorozë, për të siguruar një bazë të besueshme dhe të qëndrueshme për vlerësimin e popullsisë në nivel kombëtar dhe komunal.

Popullsia bazë dhe komponentët demografikë

Popullsia bazë

Numri bazë i popullsisë rezidente në Kosovë në fund të vitit 2023 ishte 1,603,115 banorë, sipas raportit “Vlerësimi i Popullsisë së Kosovës 2023”.

Lindjet - Në vitin 2024, numri i lindjeve të gjalla me vendbanim rezident në Kosovë ishte gjithsej 20,998 raste.

Vdekjet - Në vitin 2024, numri i vdekjeve të rezidentëve në Kosovë ishte gjithsej 10,110 raste.

Shtimi natyror - Shtimi natyror i popullsisë së Kosovës gjatë vitit 2024 ishte 10,888 banorë, duke reflektuar diferencën midis numrit të lindjeve dhe numrit të vdekjeve.

Përmirësimi metodologjik

Rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2024 treguan se mbi 95% e lindjeve dhe vdekjeve të regjistruara jashtë Kosovës i përkisnin personave pa vendbanim të përhershëm në Kosovë.

Në përputhje me këto gjetje, ASK-ja ka plotësuar metodologjinë duke përfshirë në llogaritjen e shtimit natyror vetëm lindjet dhe vdekjet që kanë ndodhur brenda territorit të Kosovës. Kjo qasje e re është formalizuar në Rregulloren e Brendshme për Metodologjinë e Vlerësimit Vjetor të Popullsisë Rezidente në Republikën e Kosovës. Kjo rregullore përcakton parimet, burimet e të dhënave, procedurat dhe përgjegjësitë institucionale, duke qenë në përputhje me definicionin ndërkombëtar të popullsisë rezidente sipas praktikave më të mira ndërkombëtare përfshi praktikat e vendeve të rajonit.

Migrimi ndërkombëtar

Imigrimi ndërkombëtar - numri i personave që kane imigruar në Kosovë nga jashtë (imigrantë ndërkombëtarë) gjatë vitit 2024 është vlerësuar të jetë gjithsej 9,038 banorë. Këto vlerësime janë bërë duke u mbështetur në burime statistikore të harmonizuara me udhëzimet metodologjike të Eurostat-it.

Emigrimi ndërkombëtar - numri i personave që janë larguar nga Kosova për të jetuar jashtë vendit (emigrantë ndërkombëtarë) gjatë vitit 2024 është vlerësuar të jetë gjithsej 37,451 banorë. Kjo përfshin migrimin për arsye të bashkimit familjar, martesës, punësimit, studimeve afatgjata dhe shpërnguljes së përhershme, veçanërisht në drejtim të vendeve të Bashkimit Evropian (BE) dhe të Zonës Evropiane të Tregtisë së Lirë (EFTA).

Bilanci i migrimit ndërkombëtar (migrimi neto) - Migrimi neto ndërkombëtar në Kosovë për vitin 2024 rezulton të jetë -28,413 banorë, duke reflektuar diferencën ndërmjet imigrimit dhe emigrimit. Ky tregues është komponent kyç në analizat demografike duke pasqyruar trendet e migrimit dhe ndikimin e tyre në strukturën e popullsisë.

Migrimi i brendshëm (kombëtar) - Gjatë vitit 2024, një numër i konsiderueshëm i popullsisë rezidente në Kosovë ka ndërruar vendbanimin brenda territorit të vendit, duke kaluar nga një komunë në tjetrën. Ky lloj migrimi i brendshëm është kryesisht rezultat i faktorëve socio-ekonomikë, përfshirë zhvendosjen nga zonat rurale në ato urbane dhe suburbane, si dhe për shkak të martesave dhe punësimit.

Sipas vlerësimeve statistikore, numri i personave që kanë ndërruar komunën e vendbanimit gjatë vitit 2024 është 21,513. Këto të dhëna janë të rëndësishme për planifikimin e zhvillimit urban, ofrimin e shërbimeve publike dhe hartimin e politikave të balancimit territorial.

Rritja e përgjithshme e popullsisë

Pavarësisht shtimit natyror pozitiv të popullsisë në vitin 2024 me 10,888 banorë, Kosova vazhdoi të përballet me një bilanc negativ të migrimit ndërkombëtar. Migrimi neto ndërkombëtar për vitin 2024 ishte -28,413 banorë, duke rezultuar në një rënie të përgjithshme të popullsisë për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2024 prej -17,525 banorësh. Ky rezultat evidencon ndikimin domethënës të migrimit në ndryshimet demografike të vendit dhe nënvizon rëndësinë e politikave të integruara për menaxhimin e migrimit dhe ruajtjen e strukturës demografike në përputhje me zhvillimet socio-ekonomike.

Tabela: 1: Popullsia e Kosovës dhe shtimi natyror për vitin 2024 në nivel të komunave

Nr.	Komuna	Popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2023)	Sipas vendbanimit të përhershëm në komunë			Popullsia dhe shtimi natyror (31 dhjetor 2024)
			Lindjet/ Nataliteti (2024)	Vdekjet/ Mortaliteti (2024)	Shtimi natyror (2024)	
1	Deçan	27 883	311	215	96	27 979
2	Gjakovë	79 031	1 031	582	449	79 480
3	Glllogoc	48 696	782	268	514	49 210
4	Gjilan	83 128	1 074	626	448	83 576
5	Dragash	29 043	228	193	35	29 078
6	Istog	33 212	383	261	122	33 334
7	Kaçanik	28 107	421	153	268	28 375
8	Klinë	30 736	443	212	231	30 967
9	Fushë Kosovë	60 209	804	238	566	60 775
10	Kamenicë	23 289	241	223	18	23 307
11	Mitrovicë	64 937	800	456	344	65 281
12	Leposaviq	9 500	37	50	-13	9 487
13	Lipjan	55 098	793	283	510	55 608
14	Novobërdë	4 507	86	57	29	4 536
15	Obiliq	22 974	382	156	226	23 200
16	Rahovec	42 175	557	271	286	42 461
17	Pejë	82 971	963	587	376	83 347
18	Podujevë	72 108	1 075	448	627	72 735
19	Prishtinë	226 068	2 870	1 152	1 718	227 786
20	Prizren	147 288	1 858	944	914	148 202
21	Skenderaj	41 316	595	316	279	41 595
22	Shtime	24 364	379	119	260	24 624
23	Shtërpçë	10 850	110	90	20	10 870
24	Suharekë	46 033	545	317	228	46 261
25	Ferizaj	108 386	1 459	581	878	109 264
26	Viti	35 809	527	229	298	36 107
27	Vushtrri	62 046	917	404	513	62 559
28	Zubin Potok	3 402	45	32	13	3 415
29	Zveçan	2 883	36	42	-6	2 877
30	Malishevë	44 269	702	240	462	44 731
31	Junik	3 940	39	29	10	3 950
32	Mamushë	5 596	76	23	53	5 649
33	Hani i Elezit	8 655	100	43	57	8 712
34	Graçanicë	17 870	151	114	37	17 907
35	Ranillug	2 482	21	27	-6	2 476
36	Partesh	3 238	26	35	-9	3 229
37	Klllokot	3 070	28	16	12	3 082
38	Mitrovicë Veriore	7 951	103	78	25	7 976
Gjithsej		1 603 115	20 998	10 110	10 888	1 614 003

Tabela: 2. Popullsia e Kosovës dhe migrimi për vitin 2024 në nivel të komunave

Nr.	Komuna	Popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2023)	Migrimi ndërkombëtar (2024)			Migrimi kombëtar (2024)			Balanci i përgjithshëm i migrimit në nivel të komunave 2024	Gjithsej popullsia dhe migrimi (31 dhjetor 2024)
			Imigrimi	Emigrimi	Bilanci i migrimit ndërkombëtar	Imigrimi	Emigrimi	Bilanci i migrimit kombëtar		
1	Deçan	27 883	131	585	-454	148	244	-96	-550	27 333
2	Gjakovë	79 031	470	2 230	-1 760	487	758	-271	-2 031	77 000
3	Glllogoc	48 696	173	1 692	-1 519	589	1 159	-570	-2 089	46 607
4	Gjilan	83 128	518	2 182	-1 665	898	967	-69	-1 734	81 394
5	Dragash	29 043	102	404	-302	130	269	-139	-440	28 602
6	Istog	33 212	147	853	-706	227	391	-164	-870	32 342
7	Kaçanik	28 107	216	696	-480	216	622	-405	-885	27 221
8	Klinë	30 736	83	1 223	-1 140	476	642	-166	-1 306	29 430
9	Fushë Kosovë	60 209	683	860	-177	4 518	722	3 796	3 618	63 827
10	Kamenicë	23 289	128	769	-640	112	467	-355	-995	22 294
11	Mitrovicë	64 937	287	1 193	-906	671	844	-173	-1 079	63 857
12	Leposaviq	9 500	6	7	-1	13	20	-7	-8	9 492
13	Lipjan	55 098	258	1 229	-971	700	767	-66	-1 037	54 061
14	Novobërdë	4 507	5	104	-99	71	70	1	-98	4 409
15	Obiliq	22 974	46	324	-278	183	375	-192	-470	22 503
16	Rahovec	42 175	161	2 080	-1 920	71	330	-258	-2 178	39 997
17	Pejë	82 971	417	1 846	-1 429	602	770	-168	-1 597	81 375
18	Podujevë	72 108	198	2 017	-1 819	635	1 757	-1 121	-2 940	69 168
19	Prishtinë	226 068	1 567	2 815	-1 249	4 369	3 169	1 200	-49	226 019
20	Prizren	147 288	1 347	3 568	-2 221	918	961	-43	-2 264	145 024
21	Skenderaj	41 316	340	1 181	-841	856	1 554	-698	-1 540	39 776
22	Shtime	24 364	117	515	-397	213	301	-88	-486	23 878
23	Shtërpçë	10 850	3	14	-11	22	106	-84	-95	10 754
24	Suharekë	46 033	198	1 564	-1 366	227	432	-205	-1 571	44 462
25	Ferizaj	108 386	582	2 041	-1 459	1 958	1 087	872	-587	107 799
26	Viti	35 809	258	1 268	-1 010	423	623	-200	-1 209	34 600
27	Vushtrri	62 046	167	1 599	-1 432	423	891	-468	-1 900	60 145
28	Zubin Potok	3 402	0	19	-19	1	16	-15	-34	3 368
29	Zveçan	2 883	0	4	-4	1	15	-14	-17	2 865
30	Malishevë	44 269	196	2 228	-2 032	555	842	-287	-2 319	41 951
31	Junik	3 940	45	90	-45	22	21	1	-44	3 895
32	Mamushë	5 596	6	19	-13	1	1	0	-13	5 583
33	Hani i Elezit	8 655	43	65	-22	25	161	-135	-157	8 498
34	Graçanicë	17 870	114	58	56	694	65	629	685	18 555
35	Ranillug	2 482	3	11	-7	13	9	3	-4	2 478
36	Partesh	3 238	6	14	-8	8	3	5	-3	3 235
37	Klllokot	3 070	8	48	-40	23	46	-23	-63	3 007
38	Mitrovicë Veriore	7 951	8	33	-26	13	39	-26	-52	7 898
Gjithsej		1 603 115	9 038	37 451	-28 413	21 513	21 513	0	-28 413	1 574 702

Tabela: 3. Popullsia e vlerësuar e Kosovës për vitin 2024 në nivel të komunave

Nr.	Komuna	Popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2023)	Shtimi natyror (2024)	Bilanci i migrimëve (2024)	Rritja e përgjithshme (2024)	Gjithsej popullsia e vlerësuar për vitin 2024 (31 dhjetor 2024)
1	Deçan	27 883	96	-550	-454	27 429
2	Gjakovë	79 031	449	-2 031	-1 582	77 449
3	Glllogoc	48 696	514	-2 089	-1 575	47 121
4	Gjilan	83 128	448	-1 734	-1 286	81 842
5	Dragash	29 043	35	-440	-405	28 637
6	Istog	33 212	122	-870	-748	32 464
7	Kaçanik	28 107	268	-885	-617	27 489
8	Klinë	30 736	231	-1 306	-1 075	29 661
9	Fushë Kosovë	60 209	566	3 618	4 184	64 393
10	Kamenicë	23 289	18	-995	-977	22 312
11	Mitrovicë	64 937	344	-1 079	-735	64 201
12	Leposaviq	9 500	-13	-8	-21	9 479
13	Lipjan	55 098	510	-1 037	-527	54 571
14	Novobërdë	4 507	29	-98	-69	4 438
15	Obiliq	22 974	226	-470	-244	22 729
16	Rahovec	42 175	286	-2 178	-1 892	40 283
17	Pejë	82 971	376	-1 597	-1 221	81 751
18	Podujevë	72 108	627	-2 940	-2 313	69 795
19	Prishtinë	226 068	1 718	-49	1 669	227 737
20	Prizren	147 288	914	-2 264	-1 350	145 938
21	Skenderaj	41 316	279	-1 540	-1 261	40 055
22	Shtime	24 364	260	-486	-226	24 138
23	Shtërpçë	10 850	20	-95	-75	10 774
24	Suharekë	46 033	228	-1 571	-1 343	44 690
25	Ferizaj	108 386	878	-587	291	108 677
26	Viti	35 809	298	-1 209	-911	34 898
27	Vushtrri	62 046	513	-1 900	-1 387	60 658
28	Zubin Potok	3 402	13	-34	-21	3 381
29	Zveçan	2 883	-6	-17	-23	2 859
30	Malishevë	44 269	462	-2 319	-1 857	42 413
31	Junik	3 940	10	-44	-34	3 905
32	Mamushë	5 596	53	-13	40	5 636
33	Hani i Elezit	8 655	57	-157	-100	8 555
34	Graçanicë	17 870	37	685	722	18 592
35	Ranillug	2 482	-6	-4	-10	2 472
36	Partesh	3 238	-9	-3	-12	3 226
37	Klllokot	3 070	12	-63	-51	3 019
38	Mitrovicë Veriore	7 951	25	-52	-27	7 923
Gjithsej		1 603 115	10 888	-28 413	-17 525	1 585 590

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

312:311(496.51)”2024”

Vlerësim : popullsia e Kosovës 2024 / Publikimin e përgatitën Arbert Abdyli, Arijeta Sojeva, Vjollca Berisha. - Botim elektronik. - Prishtinë : Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2025. - 1 burim elektronik (14 f.) : ilustr. ; 28 cm. - (Statistikat Sociale ; Seria 5)

1. Abdyli, Arbert 2. Sojeva, Arijeta 3. Berisha, Vjollca

ISBN 978-9951-30-070-4

Agjencia e Statistikave të Kosovës: Përshkrim i shkurtër

Historiku i shkurtër - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) është institucion profesional dhe i pavarur që merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare statistikore në nivel kombëtar. E themeluar që nga viti 1948, ASK ka kaluar nëpër faza të ndryshme zhvillimore, duke vepruar në përputhje me strukturat shtetërore të kohës.

Pas një ndërprerjeje në periudhën 1989–1999, ASK rifilloi aktivitetin më 2 gusht 1999 si institucion i pavarur brenda Ministrisë së Administratës Publike. Nga 1 korriku 2020 gati për dy vite të plota, veprimi në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Aktualisht funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Financimi i ASK-së bëhet nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe nga donatorë ndërkombëtarë për projekte specifike dhe ndihmë teknike.

Legjislacioni: ASK vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 për Statistikën Zyrtare dhe ndryshimeve përkatëse përmes Ligjit Nr. 06/L-058. Struktura organizative përfshin Departamente Prodhuese si Departamenti i Statistikave Ekonomike, Departamenti i Llogarive Kombëtare, Departamenti i Statistikave Sociale, Departamenti i Statistikave të Bujqësisë e Mjedisit, Departamentet mbështetëse si Departamenti i Metodologjisë dhe Teknologjisë Informative, Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim, Departamenti i Regjistrimit dhe Anketimit, Departamenti i Administratës. Në kuadër të Agjencisë veprojnë edhe Zyrat Rajonale në: Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Gjiilan, Ferizaj dhe Mitrovicë.

Misioni i ASK-së - Të ofrojë të dhëna statistikore cilësore dhe të besueshme për të gjithë përdoruesit – institucione qeveritare, komunitetin akademik, sektorin privat dhe publikun e gjerë – në mbështetje të vendimmarrjes, planifikimit dhe zhvillimit të politikave në të gjitha nivelet.

Objektivi i ASK-së - Të prodhohen dhe shpërndahen të dhënat statistikore në mënyrë sistematike, të besueshme dhe të paanshme. Përfshirë shfrytëzimin profesional dhe standardet etike, d.m.th se politikat dhe praktikrat janë transparente për shfrytëzuesit dhe respondentët e anketave.

Vizioni i ASK-së - Të jetë burimi kryesor dhe më i besueshëm i statistikave zyrtare në Kosovë, në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke mbështetur vendimmarrjen, transparencën dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Bashkëpunimet - Agjencia e Statistikave të Kosovës bashkëpunon me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës sidomos me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve si dhe Bankën Qendrore të Kosovës ku edhe përbejnë Sistemin Statistikor të Kosovës. Agjencia ka bashkëpunim të ngushtë edhe me organizata ndërkombëtare si: EUROSTAT, FMN, Banka Botërore, INSTAT, SIDA, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, VIIES, IMF, ILO STAT, UNODC, ETF, IA, OECD si dhe me institucionet statistikore të rajonit.

Gjatë vitit 2024, u realizua me sukses Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë – një projekt kyç për hartimin e politikave zhvillimore të qëndrueshme.

ASK mbulon tërë territorin e Republikës së Kosovës përmes rrjetit të njësive raportuese dhe qarqeve statistikore, duke siguruar të dhëna të dorës së parë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Adresa:

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë

Telefoni:

+383 (0) 38 200 31 129

Drejtori Ekzekutiv:

+383 (0) 38 200 31 112

Fax:

+383 (0) 38 235 033

E-mail:

infoask@rks-gov.net

Ueb-faqe:

<http://ask.rks-gov.net>

ISBN 978-9951-30-070-4



9

789951

300704